

Procedurat e Aplikimit për krijimin e ZE

Zonat Ekonomike, inicohet dhe krijohet konform Ligjit për Zonat Ekonomike, nr. 04/L-159 dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga Ligji për Zonat Ekonomike.

Procedurat për aplikim

1. Iniciuesi për krijimin e Zonës Ekonomike, fillimisht i paraqet kërkesë me shkrim Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

2. Kërkesës duhet ti bashkëngjiten:

1. Akti i themelimit (vendimi, statuti);
2. Arsyeshmëria (studimi i fizibilitetit) për krijimin e ZE;
3. Dëshminë mbi pronësinë apo posedimin/kontratën e shfrytëzimit;
4. Plani rregullues urban komunal;
5. Pëlqimin nga institucionet përgjegjëse:
 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;;
 - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – VNM;
 - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;
 - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
 - Ministria e Infrastrukturës;
 - Komuna përgjegjëse;
6. Dëshmi që ka zhvilluar konsultimet publike;
7. Projekti ideor i ZE-s ;
8. Plani investues;
9. Kohëzgjatja e operimit të Zonës;
10. Projekt për trajtimin e ujerave te zeza;
11. Projekt për furnizim me ujë;
12. Projekt për furnizim me energji elektrike-zgjidhja teknike;

3. Agjencia pas pranimit të kërkesës në afat prej 60 ditësh shqyrton kërkesën dhe i jep përgjigje aplikuesit në formë të shkruar.